



Kuvendi i Republikës së Shqipërisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI
NDËRMJET

KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE
KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Duke u bazuar në marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Kosovës, vizionit, interesave dhe qëllimeve të përbashkëta;

Duke u bazuar në vullnetin për të forcuar bashkëpunimin midis Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës;

Duke u bazuar në zhvillimet politike që po kalojnë Shqipëria dhe Kosova dhe në reformat institucionale që kanë ndërmarrë;

Duke marrë parasysh zhvillimet ekonomike rajonale e më gjerë;

Duke e vlerësuar të rëndësishme mbështetjen reciproke ndërkombëtare për pjesëmarrje në nismat rajonale dhe organizatat ndërkombëtare, si: Asambleja Parlamentare e Procesit të Bashkëpunimit të Europës Juglindore (AP e SEECP), Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës (APKiE), Asambleja Parlamentare e OSBE-së (AP e OSBE), Asambleja Parlamentare e NATO-s (AP NATO), Parlamenti Europian, Asambleja Parlamentare për Mesdheun, Asambleja Parlamentare e Unionit për Mesdheun, Unionit Ndërparlamentar, Dimensionin Parlamentar i Iniciativës së Europës Qendrore, Asambleja Parlamentare për Bashkëpunim Ekonomik me Detin e Zi, Asambleja Parlamentare e Frankofonisë dhe organizata të tjera që paraqesin interes të përbashkët të përfaqësimit;

Duke e vlerësuar të domosdoshëm bashkëpunimin për integrimin europian të Shqipërisë dhe Kosovës dhe mbështetjen e ndërsjellë në të gjitha fazat e procesit të integrit;

Mbështetur në vullnetin e përbashkët për zgjerimin dhe intensifikimin e marrëdhënieve midis Kuvendit të Republikës Shqipërisë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës;

Biem dakord të nënshkruajmë këtë memorandum bashkëpunimi.

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij memorandum bashkëpunimi është krijimi i një kuadri të përbashkët për bashkëpunimin dhe mbështetjen midis Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Neni 2

Objektivat

Ky memorandum bashkëpunimit synon:

rritjen e cilësisë së aktivitetit parlamentar në përputhje me praktikat më të mira europiane;

forcimin e bashkëpunimit midis dy kuvendeve për çështje që kanë të bëjnë me proceset e integrit në BE, përfaqësimit në organizatat ndërkombëtare dhe çështje të tjera me interes të përbashkët.

Neni 3

Fushat e bashkëpunimit

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës do të bashkëpunojnë në fusha me interes të përbashkët strategjik.

Bashkëpunimi mes dy kuvendeve do të fokusohet në fushat e mëposhtme:

Bashkëpunimi në procesin legjislativ për përafrimin e legjislacionit të dy vendeve dhe të secilit vend me legjislacionin e Bashkimit Europian.

Organizimi në mënyrë periodike të Tryezës së Kryetarëve të Komisioneve Parlamentare, ku të bashkërendohet agjenda dhe veprimet mes komisioneve parlamentare për çështje me interes të përbashkët si: integrimi europian, përafrimi i legjislacionit në fushën e ekonomisë, financave publike, investimeve, shkëmbimeve tregtare, sigurisë, mbrojtjes, arsimit, kërkimit shkencor, kulturës, medias, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, bashkëpunimit me diasporën, mbështetjes së veprimtarive prodhuese e sipërmarrjes private, administratës publike, bujqësisë e zhvillimit rural, mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, infrastrukturës dhe transportit, energjisë, qeverisjes vendore etj.

Organizimi i tryezave të përbashkëta mes komisioneve parlamentare për konsultime mbi çështje me interes të ndërsjellë sipas fushave të përgjegjësisë. Për këtë qëllim kryetarët e

komisioneve respektive në fillim të çdo viti përcaktojnë kalendarin e aktiviteteve të bashkëpunimit.

Mbështetja në fushën e diplomacisë parlamentare, bashkëpunimit dhe koordinimit të delegacioneve të përhershme të dy kuvendeve në dhe gjatë përfaqësimit/pjesëmarrjes në organizatat ndërkombëtare, nismat rajonale e më gjerë.

Konsultimet mes kryetarëve dhe sekretarëve të delegacioneve të përhershme parlamentare në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare do të mbeten prioritare, sikurse dhe bashkërendimi i qëndrimeve me interes lobimi për njohje të reja të Republikës së Kosovës.

Shkëmbimi i përvojave, praktikave më të mira dhe informacionit në nivel politik dhe nivel ekspertësh, me synimin për të zhvilluar dhe përmirësuar punën e dy institucioneve.

Dy kuvendet do të bashkëpunojnë në shkëmbimin e përvojave në fushën e mbikëqyrjes dhe kontrollit parlamentar.

Neni 4

Bashkëpunimi midis shërbimeve parlamentare

Sekretarët e përgjithshëm të dy kuvendeve angazhohen:

Të përgatitin çdo fillim viti kalendarin e aktiviteteve të përbashkëta midis shërbimeve parlamentare si dhe mbështetjen administrative, financiare dhe teknike të këtij memorandumi.

Të mbështesin shkëmbimin e praktikave më të mira në nivel ekspertësh.

Të mbështesin shkëmbimin e përvojave në fushën e edukimit qytetar dhe marrëdhëniet me Publikun, duke përfshirë këtu takime dhe aktivitete të përbashkëta që synojnë informimin dhe edukimin e publikut lidhur me aktivitetin parlamentar dhe transparencën parlamentare, bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile, grupet e interesit dhe qytetarët.

Për këtë qëllim shërbimet e Kuvendit të Shqipërisë angazhohet të ofrojnë asistencën e nevojshme për fuqizimin e kapaciteteve administrative dhe dhënien e përvojës lidhur me rritjen e transparencës në përdorimin e fondeve publike, rritjen e kapaciteteve të transmetimit për publikun të aktiviteteve të Kuvendit të Kosovës, si: mbledhjet e komisioneve parlamentare, të seancave plenare, dëgjesave publike dhe pjesëmarrjen e shoqërisë civile, botimeve parlamentare etj.

Neni 5

Ndjekja e zbatimit

Brenda një muaji nga dita e nënshkrimit të këtij memorandumi kryetarët e kuvendeve ngarkojnë një nga anëtarët e kabineteve të tyre politike për të ndjekur ecurinë e zbatimit të tij dhe të informojnë periodikisht kryetarët.

Neni 6

Kostot financiare

Kostot financiare për zbatimin e këtij memorandumi i nënshtrohen legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Kosovës. Kuvendet bien dakord që shpenzimet financiare për zbatimin e këtij memorandumi të mbulohen prej tyre.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Memorandumi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga kryetarët e kuvendeve.

Nënshkruar në TIRANË, më 20.IX.2022, në katër kopje.

Lindita NIKOLLA

**Kryetare e Kuvendit të
Republikës së Shqipërisë**



A circular official stamp of the Albanian Parliament (Kuvendi i Shqipërisë) is partially visible behind the signature. The stamp contains the text 'SHQIPËRIE' at the top and 'KUVENDI' at the bottom, with a central emblem.

Glauk KONJUFCA

**Kryetar i Kuvendit të
Republikës së Kosovës**



A circular official stamp of the Kosovo Assembly (Kuvendi i Republikës së Kosovës) is partially visible behind the signature. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E KOSOVËS' at the top and 'KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS' at the bottom, with a central emblem.